

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Si e arriti dhe e kaloi Shqipëria mesataren e BE-së... me çmimet e ushqimeve
ADRESA	https://dosja.al/aktualitet/si-e-arriti-dhe-e-kaloi-shqiperia-mesataren-e-be-se-me-cmime-t-e-ushqi-i515203
BURIMI	dosja.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	21 shtator 2026, 05:35:25 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	21 shtator 2026, 05:27:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	c318aa9ad4d4f7d704bd256b20ea890dae5b4b4557863a9fcb7af15578a9aee8
TEKSTI	0880ce048873e7d5152206fa41b628c47ede6c8942fd9aaf009d739fc13a5592
PAMJA	1de201f0d0bdc7ed0d04ca4947d2b0c8e6caa519ca5b53e53fd3877500781b69

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	400b92f1d91990d140d3ebd53488aad56bc62508954b78cafe536edd7a71f5ee
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	d754d95d3fb9effc97224ab6ddd249dd26dc09b477f9e15caf646cb8e3153b6a
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/400b92f1d91990d140d3ebd53488aad56bc62508954b78cafe536edd7a71f5ee>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



LIVE UPDATES

8 ORE ME PARE

Zgjedhjet në Rusi/ Partia e Putinit kryeson me 57.5%, qindra dronë godasin Moskën në ditën e fundit të votimit

8 ORE ME PARE

Zgjedhjet në Gjermani/ AfD kryeson në Mecklenburg-Vorpommern, Merz përballlet me presion të ri politik: Nuk do të tërhiqem nga drejtimi i partisë

12 ORE ME PARE

Dita e 113-të e protestës/ Qytetarët zbrisin sërisht në shesh, kërkohet dorëheqja e kryeministrit Rama: Ju erdhi fundi!

20 ORE ME PARE


KËRCET ARMA NË SARANDË/ Ekzekutohet Artan Myrtaj nga 2 persona me motor, plagoset dhe një kalimtar

Aktualitet

Si e arriti dhe e kaloi Shqipëria mesataren e BE-së... me çmimet e ushqimeve

Por ka të paktën një tregues ku Shqipëria jo vetëm e ka arritur Europën, por tashmë e ka kaluar: çmimet e ushqimeve.

21 Shtator 2026, 07:27
Nga E.d



Grafiku

Prej më shumë se tri dekadash, prioriteti i qeverive shqiptare ka qenë integrimi i vendit në Bashkimin Europian. Madje qeveria aktuale e ka integrimin në BE premtimin e saj kryesor.

Dhe në fakt, procesi formal ka përparuar ndjeshëm vitet e fundit: Shqipëria ka hapur të gjithë kapitujt e negociatave dhe në korrik 2026 mbylli përkohësisht tre të parët.

Por ka të paktën një tregues ku Shqipëria jo vetëm e ka arritur Europën, por tashmë e ka kaluar: çmimet e ushqimeve.

Në vitin 2025, niveli i çmimeve të ushqimeve në Shqipëri arriti në 103% të mesatares së Bashkimit Europian, duke kaluar për herë të parë referencën e 100%. Pra, një shportë ushqimore që mesatarisht kushton 100 në BE, në Shqipëri kushton rreth 103, e matur sipas standardeve të fuqisë blerëse.

Në vitin 2016, kur u shënua dhe niveli më i ulët, që nga 2005-a, kur raportohen të dhënat më të hershme, çmimet e ushqimeve ishin sa 66% e mesatares së BE-së. Në 9 vjet, treguesi u rrit me 36 pikë përqindje.

Ndërkohë, PBB-ja për frymë e Shqipërisë në 2025-n ishte vetëm 43% e mesatares së BE-së, ndërsa konsumi individual aktual për frymë (AIC), që reflekton më mirë fuqinë reale të konsumit të familjeve, ishte 48%, nga përkatësisht 30% dhe 37% në 2016-n, duke mbetur ndër të fundit në Europë.

Çmimet bënë rrugën drejt Europës shumë më shpejt

Ecuria afatgjatë e bën kontrastin edhe më të dukshëm. Në vitin 2005, niveli i çmimeve të ushqimeve në Shqipëri

editoriale

Irena Beqiraj

Kostot e jetesës edhe lajmi se ekonomia po ecën mirë

Andrey Kortunov

Zgjedhjet në Rusi janë më shumë sesa teatër politik

Në vëmendje

EDITORIAL 21 SHTATOR 2026, 07:21

Kostot e jetesës edhe lajmi se ekonomia po ecën mirë

AKTUALITET 21 SHTATOR 2026, 06:52

Rritja e shpejtë e çmimit të banesave dhe kreditë, Moody's paralajmëron Shqipërinë për goditjen që mund të marrë

POLITIKE 20 SHTATOR 2026, 16:00

ishte vetëm 73.8% e mesatares së BE-së. Në vitet që pasuan madje pati një periudhë kur diferenca me Europën u zgjerua: në 2013-2015, ushqimet kushtonin vetëm rreth 67% të mesatares europiane.

Më pas tendenca ndryshoi.

Nga 67.7% e mesatares së BE-së në vitin 2015, indeksi i çmimeve të ushqimeve u ngjiti në 81.2% në 2019, në 84.9% në 2022, në 90.7% në 2023, pothuajse u barazua me BE-në në 2024 me 99.6% dhe në 2025 e kaloi atë, duke arritur në 102.9%.

Në të njëjtën periudhë, treguesi i konsumit/të ardhurave reale për frymë në raport me BE-në u përmirësua shumë më ngadalë: nga rreth 38% në 2015 në 48% në 2025, vetëm 10 pikë përqindjeje.

Gjatë kësaj periudhe, çmimet e ushqimeve u afruan me Europën mbi tri herë më shpejt sesa fuqia ekonomike e konsumatorit shqiptar.

Por dhe kërcimi i viteve të fundit i të ardhurave duhet lexuar edhe në dritën e rishikimit të popullsisë pas Censit 2023. Numri i banorëve rezultoi rreth 2.4 milionë, nga 2.8 milionë në Censin e vitit 2011, çka, për të njëjtën madhësi ekonomie apo konsumi, rrit automatikisht vlerën e treguesve për frymë.

Për rrjedhojë, një pjesë e përmirësimit është statistikore dhe nuk përfaqëson domosdoshmërisht një rritje me të njëjtën masë të mirëqenies reale të individëve.

Shqipëria, përjashtimi i rajonit

Shtrenjtimi nuk është thjesht një pasojë e faktit që i gjithë Ballkani Perëndimor po konvergon me çmimet europiane.

Në vitin 2025, Shqipëria ishte i vetmi vend i rajonit ku çmimet e ushqimeve e kishin kaluar mesataren e BE-së.

Serbia ishte në 96.6% të mesatares europiane, Mali i Zi dhe Bosnjë-Hercegovina në 84.6%, ndërsa Maqedonia e Veriut në vetëm 74.3%.

Dhe hendeku vazhdon të zgjerohet. Në korrik 2026, çmimet e ushqimeve dhe pijeve joalkoolike në Shqipëri u rritën me 3.2% me bazë vjetore, pesë herë më shpejt se mesatarja e BE-së prej 0.6%. Në Serbi, ndërkohë, çmimet e ushqimeve ishin 5.6% më të ulëta se një vit më parë dhe në Maqedoninë e Veriut 0.3% më të ulëta.

Iluzioni i rritjes së të ardhurave

Edhe pse të ardhurat për frymë janë rritur shpejt dhe Shqipëria është ngjitur në vendin e tretë në rajon në terma nominalë, me 11.2 mijë dollarë për frymë në 2025, fuqia reale blerëse mbetet dukshëm më e ulët.

Kur korrigjohen sipas çmimeve, Shqipëria zbret në vendin e katërt, me vetëm 23.4 mijë dollarë ndërkombëtarë për frymë, shumë poshtë Maqedonisë së Veriut me 29.7 mijë.

Arsyeja është se vendi është shtrenjtuar shumë shpejt: niveli i përgjithshëm i çmimeve arriti në 72.6% të mesatares së BE-së, ndërsa çmimet e ushqimeve në 102.9%, duke bërë që rritja e të ardhurave të përkthehet në një fuqi blerëse shumë më të kufizuar./Monitor

shqipëria

be

çmimet

Sondazh

Poll

Nga “George Washingtoni i Kosovës” te Haga/ Hashim Thaçi, njeriu i 17 shkurtit nën hijen e 16 shtatorit

më të klikuarat

FOTO/ Kush është Artan Myrtaj që u ekzekutua ditën e sotme, viktima njihet si 'Tani Ruzhdiut'

KPP vë në rrezik sinjalin e RTSH-së. Bashkë me të dhe radiot e policisë dhe antenat e Shish e Albcontrol. Mban peng prej muajsh tenderin e mirëmbajtjes së rrjetit DVB-T2

VIDEO/ Falsifikim dokumentash dhe përfitim i paligjshëm i pronave, arrestohet ish-drejtori i Kadastrës në Fier, detyrim paraqitje për topografin

DETAJET/ Si u vra Artan Myrtaj në Sarandë, u qëllua nga dy persona me motor

insights

Rezarta Gagani
Përballë pallatit tim po ndërtohet një pallat

Auron Janku
Kur PARTITË harrojnë pse ekzistojnë

Ola Xama
Republika e 1 euroshit ku Rama zgjedh kush bëhet biznesmen

Idriz Konjari
Sa gati është biznesi shqiptar për tu përshtatur me tregun e BE-së?

Moti

Powered by  tomorrow.

Aktualitet
21 Shtator 2026, 07:08

Reshje dhe shtrëngata në disa zona, parashikimi i motit për sot

Foto ilustruese TIRANA- Vendi ynë do të vijojë të ndikohet nga kushte atmosferike relativisht të paqëndrueshme, duke sjellë...

Rritja e shpejtë e çmimit të banesave dhe kreditë, Moody's paralajmëron Shqipërinë për goditjen që mund të marrë

Aktualitet
21 Shtator 2026, 06:52

“Nesër më shumë”/ Mbyllet protesta e 113-të: Pa rini nuk ka Shqipëri!

Aktualitet
20 Shtator 2026, 22:00

“Ministri e Vdekjes”/ Vijon marshimi në Tiranë, protestuesit ndalen para Ministrisë së Shëndetësisë

Aktualitet
20 Shtator 2026, 21:50

Qëlloi për vdekje shqiptarin i cili kishte hyrë për të vjedhur, autori: Jam i dëshpëruar

Aktualitet
20 Shtator 2026, 21:42

Aktualitet
20 Shtator 2026, 21:11

Lufta për trafikun e drogës në Sicili/ Përplasja mes klaneve rivale përfshin edhe shqiptarë

Personat e përfshirë në konflikt ITALI- Një përplasje mes grupeve kriminale për kontrollin e trafikut të drogë...

Protesta e 113-të/ Mbyllen fjalimet para Kryeministrit, qytetarët nisin marshimin: Rama jepe dorëheqjen

Aktualitet
20 Shtator 2026, 20:34



"Më 24 shtator, të gjithë para Parlamentit"/ Aktivistja Arvina Lleshi: Deputetët do votojnë projektligjet antishqiptare, Shqipëria nuk është e qeverisë

Aktualitet
20 Shtator 2026, 20:26



"Parlamenti nuk na përfaqëson"/ Qytetarja nga protesta: Shqiptarët duan ndryshim

Aktualitet
20 Shtator 2026, 20:18



"Të zhbëhen ndryshimet kushtetuese të vitit 2008"/ Aktivisti: Duhet zgjidhje reale, Kuvendi nuk na përfaqëson

Aktualitet
20 Shtator 2026, 19:50


MË SHUMË



dosja

20 Shtator 2026


Më 24 shtator, të gjithë para Parlamentit"/ Aktivistja Arvina Lleshi: Deputetët do votojnë projektligjet antishqiptare, Shqipëria nuk është e qeverisë



Aktivistja Arvina Lleshi: Deputetët do votojnë projektligjet antishqiptare, Shqipëria...



"Parlamenti nuk na përfaqëson"/ Qytetarja nga protesta: Shqiptarët duan ndryshim



"Të zhbëhen ndryshimet kushtetuese të vitit 2008"/ Aktivisti: Duhet zgjidhje reale...



Protesta kundër qeverisë/ Nis marshimi drejt Kryeministrit

Aktivistja Arvina Lleshi: Deputetët do votojnë projektligjet antishqiptare, Shqipëria...

 Shiko video te tjera



KTHEHU NE KRYE 

Dosja.al është një iniciativë gazetarësh të rinj dhe njerëzish të lirë, që nuk ndikohet nga interesa politike apo biznesi. Informimi i paanshëm, qëndrimi i pavarur dhe etika profesionale janë parimet tona. Ka media të majta, të djathta, ka media në shërbim të partive apo biznesit, por ka edhe të pavarura, që kanë zgjedhur rrugën më të vështirë, por më të ndershme dhe më të sigurtë për të qenë të besueshëm. Dosja.al do të jetë gjithmonë e pavarur, e vërtetë, në krah të interesit publik.

Telefon/Whatsapp: +355 68 2676 444

AKTUALITET

POLITIKE

EKONOMI

BOTA

SDPT

Drejtör: Enton Abilekaj

Kryeredaktor: Izmir Akulli

Gazetarë:

Esmeralda Doçi

Emanuela Dida

Eliza Vasa

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.